

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar

P9

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 28.09.2019

Problemi 1. Në vijim janë dhënë draft Pasqyrat e Pozitës Financiare të Austin sh.a dhe filialeve të saj Boston sh.a dhe Cleveland sh.a me 31 dhjetor 2018:

	Austin sh.a	Boston sh.a	Cleveland sh.a
Pasuritë:	€'m	€'m	€'m
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>			
Trupëzuara	1,950	950	865
Patrupëzuara	50		
Investimet në ekuitet	1,900		
Pasuritë qarkulluese	<u>1,150</u>	<u>545</u>	<u>635</u>
Total pasuritë	5,050	1,495	1,500
Ekuiteti dhe detyrimet:			
<i>Ekuiteti</i>			
Kapitali aksionar	1,200	420	320
Fitimet e mbajtura	1,100	398	405
Rezervat tjera	<u>1,050</u>	<u>212</u>	<u>335</u>
Total Ekuiteti	3,350	1,030	1,060
Detyrimet afatgjata	1,200	400	165
Detyrimet afatshkurtëra	<u>500</u>	<u>65</u>	<u>275</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	5,050	1,495	1,500

Informatat shtesë në vijim kanë të bëjnë me Austin sh.a, Boston sh.a dhe Cleveland sh.a:

- (i) Austin sh.a bleu 90% të ekuitetit të Boston sh.a's me 1 janar 2011 me një kosto prej €900 milion kur fitimet e mbajtura dhe rezervat tjera të Boston sh.a ishin €260 milion dhe €190 milion respektivisht. Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Boston sh.a-së dhe interesat jo-kontrollues në Boston sh.a me 1 janar 2011 ishin €905 milion dhe €100 milion respektivisht. Interesat jo-kontrollues në blerje të Boston sh.a ishin matur sipas vlerës së drejtë. Teprica e vlerës së drejtë të pasurive neto të Boston sh.a-së mbi vlerat e tyre bartëse i është atribuar një zëri të fabrikës e cila kishte jetë të mbetur ekonomike të përdorimit prej 10 viteve me 1 janar 2011.
- (ii) Grupi Austin sh.a ka njohur një humbje totale nga dëmtimi në shumë prej €25 milion lidhur me zërin e mirë në blerje të Boston sh.a në peridhën raportuese para 1 janar 2018.
- (iii) Me 1 prill 2018, Austin sh.a shiti 30% të pronësisë në Boston sh.a për një konsideratë në para në shumë prej €300 milion. Vlera e drejtë e pronësisë së mbetur në Boston sh.a në atë datë ishte €675 milion. Austin sh.a nuk e ka kontabilizuar këtë shitje në draft pasqyrat financiare përveç kreditimit të plotë të arkëtimeve nga shitja në fitim ose humbje.
- (iv) Austin sh.a bleu 70% të ekuitetit të Cleveland sh.a-së me 1 janar 2016 me një kosto prej €480 milion kur fitimet e mbajtura dhe rezervat tjera të Cleveland sh.a ishin €200 milion dhe €100 milion respektivisht. Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme dhe të interesit jo-kontrollues të Cleveland sh.a-së me 1 janar 2016 ishin €650 milion dhe €300 milion respektivisht. Interesat jo-kontrollues në blerjen e Cleveland sh.a-së maten sipas pjesës së tyre proporcionale në pasuritë neto të identifikueshme të Cleveland sh.a-së në blerje. Teprica e vlerës së drejtë të pasurive neto të identifikueshme të Cleveland sh.a-së

mbi vlerat e tyre bartëse i është atribuar një zëri të fabrikës e cila kishte jetë të mbetur të përdorimit prej 5 viteve me 1 janar 2016.

Austin sh.a bleu edhe 10% të ekuitetit të Cleveland sh.a-së me 1 tetor 2018 me një kosto prej €110 milion.

- (v) Rishikimet për humbjet nga dëmtimi janë kryer me 31 dhjetor 2018 sa i përket Boston sh.a dhe Cleveland sh.a si njësi gjeneruese të parasë. Shumat e rikuperueshme sa i përket pasurive neto të Boston sh.a dhe Cleveland sh.a me 31 dhjetor 2018 ishin €1,050 milion dhe €1,080 milion respektivisht. Në të dy rastet, supozo që humbjet nga dëmtimi nëse ka janë shkaktuar në fund të vitit.
- (vi) Investimet e Austin sh.a-së në Boston sh.a dhe Cleveland sh.a janë të vetmit zëra të cilët përbëjnë investimet në ekuitet në Pasqyrën e Pozitës Financiare të Austin sh.a-së. Në përgaditjen e pasqyrave të veçanta financiare Austin sh.a ka bërë një vendim të parevokueshëm që të trajtoj të dy investimet si zëra sipas vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse në pajtim me SNRF 9 *Instrumentet Financiare*.
- (vii) Një përmbledhje e rezultateve të Austin sh.a, Boston sh.a dhe Cleveland sh.a nga pasqyrat e tyre të Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Tjera Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018 është si në vijim:

	Austin sh.a	Boston sh.a	Cleveland sh.a
	€'m	€'m	€'m
Fitimi për vitin	360	24	36
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	<u>60</u>	<u>18</u>	<u>12</u>
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse	420	42	48

Mund të supozohet se rezultatet e mësipërme përlllogaritën njetrajtësisht përgjatë periudhës raportuese. Vetem Austin sh.a ka paguar dividendë në shumë prej €80 milion gjatë periudhës.

- (viii) E përfshirë në pronën, fabrikën dhe paisjet të Austin sh.a-së është edhe një pronë e blerë me 1 janar 2015 me një kosto prej €350 milion. Prona është subjekt i rivlerësimit në pajtim me modelin e rivlerësimit sipas SNK 16 Prona, Fabrika dhe Paisjet. Jeta totale ekonomike e përdorimit është vlerësuar të jetë 100 vite. Me 31 dhjetor 2017, prona është rivlerësuar me një vlerë të drejtë prej €320 milion. Prona ende nuk është rivlerësuar me 31 dhjetor 2018 në vlerën e saj të drejtë prej €335 milion.
- (ix) Me 31 dhjetor 2018, Austin sh.a kishte një divizion i cili është duke u shitur si një njësi në një transaksion të vetëm. Kushtet për klasifikim si një grup për shitje/largim sipas SNRF 5 Pasuritë Jo-qarkulluese të Mbajtura për Shitje dhe Operacionet e Ndërprera janë përmblusur sa i përket këtij divizioni. Çmimi i vlerësuar i shitjes së këtij divizioni është vlerësuar të jetë €350 milion para kostove të shitjes. Kostot e shitjes janë vlerësuar të jenë 10% e çmimit të shitjes.

Vlerat bartëse në vijim të neto pasurive të divizionit me 31 dhjetor 2018 janë përfshirë në pasqyrën e pozitës financiare të Austin sh.a-së me sipër:

	€'m
Prona, fabrika dhe paisejt	400
Patenta	20
Pasuritë qarkulluese	30
Detyrimet afatshkurtëra	<u>(40)</u>
	410

Kërkohet:

Përgadite Pasqyrën e Konsoliduar të Pozitës Financiare të grupit Austin sh.a me 31 dhjetor 2018.

(30 pikë)

1.

Grupi Austin sh.a

Pasqyra e Konsoliduar e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2018:

Pasuritë:	€'m
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Trupëzuara (ll.1)	3,395.3
Patrupëzuara (ll.2)	<u>36</u>
	3,431.3
Pasuritë qarkulluese (ll.3)	<u>2,655</u>
Total pasuritë	6,086.3
Ekuiteti dhe detyrimet:	
<i>Ekuiteti</i>	
Kapitali aksionar	1,200
Fitimet e mbajtura (ll.7)	861.6
Rezervat tjera (ll.10)	<u>793.3</u>
Ekuiteti i atribuar pronarëve të prindit	2,854.9
Interesat jo-kontrollues (412(ll.11)+214.4(ll.13))	<u>626.4</u>
Total ekuiteti	3,481.3
Detyrimet afatgjata (1200+400+165)	1,765
Detyrimet afatshkurtëra (500+65+275)	<u>840</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	6,086.3

Llogaritjet:

1. Pasuritë jo-qarkulluese të prekshme	€'m
Shumat e dhëna:	
Austin sh.a	1,950
Boston sh.a	950
Cleveland sh.a	<u>865</u>
	3,765
Korigjimet:	
Fitimi nga VD në blerjen e Boston sh.a (905-420-260-190)	35
Fitimi nga VD në blerjen e Cleveland sh.a (650-320-200-100)	30
Zhvlerësimi i VD nga Austin sh.a (35÷10 x 8 vite)	(28)
Zhvlerësimi i VD Austin sh.a (30÷5 x 3 vite)	(18)
Rivlerësimi i Austin sh.a's PFP me 31 dhjetor 2018:	
VD me 31 dhjetor 2018	335
Vlera bartëse me 31 dhjetor 2018 (320-320÷97 x 1)	<u>(316.7)</u>
NjGjP humbjet e dëmtimit të alokuara tek PFP:	
Boston sh.a (ll.5)	(7)
Riklasifiko PFP në grupin e heqjes TMSH të pasuritë qarkulluese	<u>(400)</u>
PJQ të prekshme të grupit 31 dhjetor 2018	3,395.3

2. Pasuritë jo qarkulluese të paprekshme	€'m
Shumat e dhëna: Austin sh.a	50
Korigjimet:	
Zëri i mirë ne blerje të Cleveland sh.a (11.4)	6
Riklasifiko patenten në grupin e heqjes tek pasuritë qarkulluese	<u>(20)</u>
PJQ të paprekshme të grupit me 31 dhjetor 2018	36

3. Pasuritë qarkulluese	€'m
Shumat e dhëna:	
Austin sh.a	1,150
Boston sh.a	545
Cleveland sh.a	<u>635</u>
	2,330
Korigjimet:	
Riklasifikim i PFP tek grupi për largim i MPSH në pasuritë qarkulluese	400
Riklasifikim i patentes tek grupi për largim i MPSH në pasuritë qarkulluese	20
Humbjet nga dëmtimi në grupin për largim MPSH:	
VD minus kostot e shitjes 90% x 350	315
Vlera bartëse	<u>(410)</u> <u>(95)</u>
Pasuritë qarkulluese të grupit me 31 dhjetor 2018	2,655

4. Zëri i mirë në blerjen e filialeve:	Boston sh.a	Cleveland sh.a
	€'m	€'m
Kosto e blerjes	900	480
IJK në blerje	100	(30% x 650) 195
VD e NP të identifikueshme në blerje	<u>(905)</u>	<u>(650)</u>
Zëri i mirë në blerje	95	25
Minus dëmtimet deri me 31 dhjetor 2017	<u>(25)</u>	<u>-</u>
Zëri i mirë me 1 janar 2018	70	25
Dëmtimet gjatë vitit 2018	<u>(70)</u> (11.5)	<u>(19)</u> (11.6)
Zëri i mirë i raportuar me 31 dhjetor 2018	-	6

5. Rishikimi për demtim në Boston sh.a me 31 dhjetor 2018:	€'m
Shuma e rikuperueshme	1,030
Vlerat bartëse:	
Pasuritë e identifikueshme:	
Të dhëna	1,030
Fitmet VD minus zhvl. akumul. (35-28)	<u>7</u>
	1,037
Zëri i mirë	<u>70</u>
	<u>1,107</u>
Total humbja nga dëmtimi (1,107-1,030)	77
Alokimi i humbjes tek NjGjP:	
Së pari tek zëri i mirë deri në vlerën bartëse	70
Saldo te PFP (77-70)	<u>7</u>
	77

6. Rishikimi për dëmtim në Cleveland sh.a me 31 dhjetor 2018:	€'m
Shuma e rikuperueshme	1,080
Vlerat bartëse:	
Pasuritë e identifikueshme:	
Të dhëna	1,060
Fitimet VD minus zhvl. akumul. (30-18)	<u>12</u>
	1,072
Zëri i mirë (bruto) (25/0.7)	<u>35.1</u>
	1,107.1
Total humbja nga dëmtimi (1,107.1-1,080)	27.1
Alokimi i humbjes tek NjGjP:	
Së pari tek zëri i mirë deri në vlerën bartëse	27.1
Saldo te PFP (27.1-27.1)	-
	<u>27.1</u>
Humbja që duhet të njihet (27.1 x 70%)	19.0

7. Fitimet e mbajtura të grupit:	€'m
Austin sh.a FM, të dhëna	1,100
Pjesa e fitimeve të mbajtura të filialave pas blerjeve:	
Boston sh.a; 90% (380(II.8)-260)	108
60% (398-380(II.8))	10.8
Cleveland sh.a; 70% (396(II.9)-200)	137.2
80% (405-396(II.9))	7.2
VD zhvlerësimi:	
Boston sh.a; (90% x 28 x 7.25/8+60% x 28 x 0.75/8)	(24.4)
Cleveland sh.a; (70% x 18 x 2.75/3+80% x 18 x 0.25/3)	(12.8)
Rikthim i arkëtimeve nga shitja e pronësisë në Boston sh.a	(300)
Humbjet nga dëmtimi:	
Zëri i mirë në Boston sh.a (70 x 60%+25 x 90%)	(64.5)
Zëri i mirë në Cleveland sh.a	(19)
PFP në Boston sh.a (7 x 60%)	(4.2)
PFP dhe patenta në Austin sh.a	(95)
Fitimi nga rivlerësimi i pronës së Austin sh.a:	
Vlera bartëse sipas modelit të kostos (350 x 96/100)	336
VD në rivlerësim	335
I tërë fitimi është brenda vlerës bartëse sipas modelit të kostos	
Andaj i tërë fitimi duhet të raportohet ne F/H (II.1)	<u>18.3</u>
Fitimet e mbajtura të grupit me 31 dhjetor 2018	861.6

8. FM dhe rezervat tjera të Boston sh.a me 1 prill 2018:	FM	Rezervat tjera
	€'m	€'m
Saldot me 31 dhjetor 2018	398	212
Minus rezultati për 9 muajt e fundit	9/12 x 24 <u>(18)</u>	9/12 x 18 <u>(13.5)</u>
Saldo me 1 prill 2018	380	198.5

9. FM dhe rezervat tjera të Cleveland sh.a me 1 prill 2018: FM			Rezervat tjera
		€'m	€'m
Saldot me 31 dhjetor 2018		405	335
Minus rezultati për 3 muajt e fundit	3/12 x 36	<u>(9)</u>	3/12 x 12 <u>(3)</u>
Saldo me 1 prill 2018		396	332

10. Rezervat tjera të grupit:

	€'m
Rezervat tjera të Austin sh.a të dhëna	1,050
Pjesa e rezervave tjera pas blerjes së filialeve:	
Boston sh.a; 90% (198.5(II.8)-190)	7.7
60% (212-198.5(II.8))	8.1
Cleveland sh.a; 70% (332(II.9)-100)	162.4
80% (335-332(II.9))	2.4
Anulim i fitimeve nga rimatja e investimeve në filiale	
Investimet sipas VDNTTGJ:	
VD (shuma bartëse në PPF të Austin sh.a)	1,900
Minus kosto origjinale (900+480+110)	<u>(1,490)</u> (410)
Neto korigjimet në ekuitet të Austin sh.a duke zvogëluar mbajtjen në Boston sh.a:	
Arkëtimet nga largimi	300
Neto pasuritë e transferuara tek IJK (II.11)	<u>(323.4)</u> (23.4)
Neto korogjimet në ekuitet për rritjen e pronësisë në Cleveland sh.a:	
Transfer nga IJK (shih llogaritjen IJK)	106.1
Kosto e pronësisë shtesë	(110) <u>(3.9)</u>
Rezervat tjera të grupit	793.3

11. Interesi jo-kontrollues në Boston sh.a:

	€'m
Në blerje	100
Ndryshimet pas blerjes deri me 1 prill 2018:	
FM 10% (380(II.8)-260)	12
VD zhvlerësimi (10% x 28 x 7.25/8)	(2.5)
Humbjet nga dëmtimi:	
Zëri i mirë në Boston sh.a (25 x 10%)	(2.5)
Rezervat tjera 10% (198.5(II.8)-190)	<u>0.9</u>
IJK me 1 prill 2017 para zvogelimit të pronësisë nga Austin sh.a	107.9
Rritja në IJK në Austin sh.a zvogelimi i pronësisë (II.12)	<u>323.4</u>
IJK me 1 prill 2017 pas zvogëlimit të pronësisë së Austin	431.3
Ndryshimet pas blerjes pas 1 prill 2018:	
FM 40% (398-380(II.8))	7.2
VD zhvlerësimi (40% x 28 x 0.75/8)	(1.1)
Humbjet nga dëmtimi:	
Zëri i mirë në sh.a (70 x 40%)	(28)
PPF në Boston sh.a (7 x 40%)	(2.8)
Rezervat tjera 40% (212-198.5(II.8))	<u>5.4</u>
IJK në Boston sh.a me 31 dhjetor 2018	412

12. Rritja ne IJK në Boston sh.a me 1 prill 2018 në kur Austin sh.a zvogëlon pronësinë.

€'m

Neto pasuritë e Boston sh.a me 1 prill 2018:

Identifikueshme:

Kapitali aksionar plus rezerva (420+380+198.5) 998.5

Neto fitimi nga VD (35-28 x 7.25/8) 9.6

1,008.1

Vlea bartëse e zërit të mirë me 1 prill 2018 70

1,078.1

Neto pasuritë të transferuara tek IJK $1,078.1 \times 30\%$ 323.4**13. IJK në Cleveland sh.a**Në blerje $30\% \times 650$ 195

Ndryshimet pas blerjes para se Austin sh.a të rrisë pronësinë:

RE $30\%(396(11.9)-200)$ 58.8VD zhvlerësimi $(30\% \times 18 \times 2.75/3)$ (5.0)Rezervat tjera $30\%(332(11.9)-100)$ 69.6

IJK me 1 tetor 2018 para se sh.a të rrisë pronësinë 318.4

Zvogëlimi në IJK në Austin sh.a rritja e pronësisë $10/30 \times 318.4$ (106.1)

IJK me 1 tetor 2018 menjëherë pas rritjes së pronësisë 212.3

Ndryshimet pas blerjes pasi që Austin sh.a rrit pronësinë:

FM $20\%(405-396(11.9))$ 1.8VD zhvlerësimi $(20\% \times 18 \times 0.25/3)$ (0.3)Rezervat tjera $20\%(335-332(11.9))$ 0.6

IJK në Cleveland sh.a me 31 dhjetor 2018 214.4

Problemi 2.

Sacramento sh.a është një kompani e listuar në bursë. Sacramento sh.a i dha një kredi prej €25 milion një organizatë bamirësie për të ndërtuar një qendër të komunitetit të njëjërëzve pa shtëpi. Kredia është dhënë me 1 janar 2018 dhe është e ripagueshme kur të maturon pas katër viteve. Interesi, i cili është i subvencionuar, do të ngarkohet çdo vit në fund të vitit me normën prej 4%, por Sacramento sh.a vlerëson që norma normale e interest për një kredi të tillë duhet të ishte 8%. Sacramento sh.a e regjistroi një pasuri financiare prej €25 milion dhe e zvogëloi këtë më shumë e interest të pranuar çdo vit.

Periudha	Faktori Skontues 4%	Faktori Skontues 8%
1	0.962	0.926
2	0.925	0.857
3	0.889	0.794
4	0.855	0.735

Kërkohet:

Në pajtim me *SNRF 9 Instrumentet Financiare*, rekomando me justifikim trajtimin e kërkuar në kontabilitet për lejimin e kredisë tek organizata e bamirësisë në pasqyrat financiare të Sacramento sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. (10 pikë)

2.

a)

Vlera e drejtë e kredisë është përcaktuar duke llogaritur vlerën e tanishme të të gjitha rrjedhave të ardhshme të parasë duke përdorur normën e interes që mbizotëron në treg për një instrument financiar të ngjajshëm. Kjo do të rezultoj me një shifër më të vogël se sa shumat e dhëna. Diferenca njihet në fitim ose humbje.

	Rrjedhat e parasë	Faktori skontues	VT
	€m	8%	€m
2018	1	0.926	0.926
2019	1	0.857	0.857
2020	1	0.794	0.794
2021	26	0.735	<u>19.111</u>
			21.688

Vlera e drejtë e kredisë është llogaritur duke llogaritur rrjedhat e parasë përgjatë jetës së kredisë dhe duke i skontuar në vlerën e tanishme me normën e pasubvencionuar të interesit prej 8%.

Dhënia e kredisë duhet të kontabilizohet si në vijim:

	€m	€m
D Pasuritë financiar	21.688	
D Fitimi ose humbje	3.312	
K Paraja		25

Pasuria mbahet sipas kostos së amortizuar.

1 janar 2018	Norma e interesit	Paraja e pranuar	31 dhjetor 2018
€m	(8%)	€m	€m
21.688	1.735	(1)	22.423

Hyrjet korigjuese:

	€m	€m
D PFHTTGJ	3.312	
K Pasuri financiare		3.312
D Pasuri financiare	1.735	
K PFHTTGJ		1.735

Problemi 3. SNK 33 – Fitimet për aksion përshkruan kërkesat për llogaritjen dhe shpalosjen e fitimit të thjeshtë për aksion për entitetet e listuara. Shifrat në vijim janë ekstraktuar nga pasqyrat financiare të Providence sh.a:

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Tjera Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 mars 2019 (Ekstrakt)

	€ milion
Fitimi para tatimit	275
Tatimi	<u>(35)</u>
Fitimi për vitin	240
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin	<u>25</u>
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	265
Informatat tjera:	
Dividendat e aksioneve të zakonshme e paguar	67
Dividendat preferenciale të paguara nga ekuiteti	12
Aksione të zakonshme të emetuara me 1 prill 2018 (vlera nominale për aksion €1)	125
Aksione preferenciale me 6% me 1 prill 2018	200

Gjatë vitit të përfunduar me 31 mars 2019, ndodhën transaksionet në vijim lidhur me kapitalin aksionar të emetuar të Providence sh.a:

- (i) 10 milion aksione të zakonshme të emetuara lidhur me blerjen e një biznesi tjetër. Këto ishin emetuar me vlerë të plotë të tregut në datën e emetimit, 1 korrik 2018.
- (ii) 20 milion aksione të zakonshme të emetuara për para për aksionarët ekzistues me 1 tetor 2018. Çmimi i emetimit ishte €14 për aksion, që ka paraqitur një zbritje prej 30% nën çmimin e tregtuar menjëherë para emetimit (€20 për aksion).
- (iii) Me 1 mars 2019, Providence sh.a ri-bleu 5 milion aksione sipas çmimit të tregut.
- (iv) Me 31 mars 2019, një emetim bonus është përfunduar duke emetuar 3 aksione të reja për çdo aksion që ka qënë i emetuar në atë datë.

Kërkohet:

- (a) Trego shkurtazi se si SNK 33 *Fitimet për aksion* kërkon që të përcaktohet shifra e fitimeve me qëllim të llogaritjes së fitimit për aksion. (6 pikë)
- (b) Duke përdorur informatat, llogarite fitimin bazik për aksion për vitin e përfunduar me 31 mars 2019 dhe shifrën krahasuese për vitin e përfunduar me 31 mars 2018 që duhet të raportohet në pasqyrat financiare të vitit 2019. FPA e raportuar më heret në vitin 2018 ishte €1.60. (14 pikë)

[Total: 20 pikë]

3.

(a) Sipas SNK 33 Fitimet për aksion, shifra e fitimeve për qëllim të llogaritjes së FPA-së duhet të jetë fitimi i vitit i atribuar mbajtësve të aksioneve të zakonshme. Në praktikë, kjo zakonisht përbëhet nga fitimi pas tatimit, pas zërave të pazakonshëm, pas deklarimit të çfardo dividende preferenciale, por para dividëntës së aksioneve të zakonshme.

(b) Llogaritja e fitimeve:	€ milion
Fitimi për vitin (pas tatimit)	240
Minus dividendat preferenciale	(12)
Fitimi për qëllim të FPA-së	228

Total numri i aksioneve të emetuara për vitin:	milion
Nr. i aksioneve të ekuitetit në emetim me 1 prill 2018	125
Aksione të reja të emetuara për blerjen e biznesit	10
Aksione të reja të emetuara për para	20
Aksionet e riblera (trajtohen si të anuluar)	(5)
Totali para emetimit bonus	150
Emetimi bonus 3 për 1	450
Total numri i aksioneve të ekuitetit me 31 mars 2019	600

Llogaritja e mesatares së ponderuar:

Datat	Numri i aksioneve (milion)	Pesha e kohës	Fraksioni bonus (shih LL1 më poshtë)	Mesatarja e ponderuar (milion)
1 prill – 1 korrik	125	*3/12	*20 / 19.23 *4/1	130.01
1 korrik – 1 tetor	125 + 10 = 135	*3/12	*20 / 19.23 * 4/1	140.41
1 tetor – 1 mars	135 + 20 = 155	*5/12	*4/1	258.33
1 mars – 31 mars	155 - 5 = 150	*1/12	*4/1	50.00
31 mars	150 + 450 = 600	0		0
Total				578.75

LL1: Fraksioni bonus kërkohet për aksione të emetuara me vlerë më të ulët se e tregut.

Emetimi i të drejtave:

Me 1 tetor 2018, 20 milion aksioneve janë emetuar tek aksionarët ekzistues me një çmim në zbritje. Fraksioni bonus llogaritet si çmimi aktual para emetimit të të drejtave pjesëtuar me çmimin teorik pa të drejtave. Na duhet të llogarisim ÇTPD.

Do të jenë 135 milion aksione në emetim para emetimit të të drejtave. Pra është e drejtë të themi se çdo aksionari me 135 aksione i janë ofruar 20 aksione të reja.

Vlera e mbajtjes para emetimit të të drejtave: $135 * €20 = €2,700$

Vlera e shtuar me emetimin e të drejtave: $20 * €14 = €280$

Total vlera pas emetimit të të drejtave: 155 aksione = €2,980

Andaj ÇTPD është $\text{€}2,980 / 155 \text{ aksione} = \text{€}19.23$ për aksion

Ora fraksioni bonus është $= 20 / 19.23$

Kjo aplikohet për të gjitha periudhat para emetimit të të drejtave.

Emtimi bonus:

Fraksioni për emetimin bonus për emetimin bonus është numri i aksioneve në emetim pas emetimit bonus pjesëtuar me numrin e aksioneve të emetuara para emetimit. Pra, $600/150$ ose $4/1$.

Fitimi i thjeshtë për aksion $= 228 / 578.75 = \text{€}0.39,40$ ose 39c

Riparaqitja e informatës krahasuese me 2018:

Me qëllim të korigjimit të informatës krahasuese, ne duhet të shumëzojmë këtë me vlerën e kundërt të të dy fraksioneve të bonusit.

Pra $\text{€}1.60 * 19.23 / 20 * \frac{1}{4} = \text{€}0.3846$ ose 38c

Problemi 4. SNRF 11 – Aranzhimet e përbashkëta është publikuar në maj 2011. I vendos parimet për kontabilitetin e aranzhimeve të cilat janë të kontrolluara bashkarisht nga dy ose më shumë palë. Standardi i klasifikon aranzhimet e përbashkëta në dy lloje: Operacionet e Përbashkëta dhe Sipermarrjet e Përbashkëta.

- (i) Me 1 gusht 2017, Santa Fe sh.a, një kompanie e cila ka në pronësi një kantier detar, i është kërkuar që të ndërtoj një anije të madhe për një klient. Klienti ka kërkuar aftësi të veçanta të cilat kërkojnë dizajnim të veçantë të sistemit shtytës (motorit).

Kantieri detar hyri në kontratë me një prodhues të motorëve në të cilën çmimi total i anijës do të jetë €100 milion dhe do të ndahet 80% për kantierin detar dhe 20% për prodhuesin e motorit. Sipas marrëveshjes Santa Fe sh.a do të përfundoj strukturën e anijes, dhe prodhuesi i motorit do të dizajnoj dhe furnizoj motorin. Gjatë vitit të përfunduar me 31 korrik 2018 anija ishte përfunduar sipas afatit dhe konsiderata ishte paguar sipas marrëveshjes. Kostot e shkaktuara nga Santa Fe sh.a ishin €62 milion.

- (ii) Me 1 gusht 2017, Santa Fe sh.a hyri në një marrëveshje me një kompani tjetër për të zhvilluar një katntier detar modern. Të dy kompanitë e themeluan një entitet të ri dhe investuan €130 milion secila në entitetin e ri. Ata u pajtuin që të menaxhojnë këtë entitet së bashku. Gjatë vitit të përfunduar me 31 korrik 2018 kantieri detar ishte përfunduar dhe gjeneroi një fitim prej €4 milion.

- (iii) Santa Fe sh.a ka një interes prej 50% në ekuitetin e një entiteti tjetër Raleigh sh.a. Raleigh sh.a menaxhon një linjë të udhëtimit me anije, dhe ka pasuri prej €50 milion dhe detyrime prej €45 milion me 1 gusht 2017. Humbjet tregtare për vitin e përfunduar me 31 korrik 2018 ishin €4.8 milion. Pjesa tjetër e interesit në ekuitet prej 50% mbahet nga një entitet tjetër, por vendimet ditore menaxheriale bëhen nga Santa Fe sh.a. Santa Fe sh.a ka caktuar 4 drejtorë në bordin prej 5 personave të Raleigh sh.a.

Kërkohet:

- (a) Trego dallimin ndërmjet dy llojeve të aranzhimeve të përbashkëta të përshkruara nga SNRF 11 – Aranzhimet e përbashkëta. (8 pikë)
- (b) Në rastin e (i), (ii) dhe (iii) mësipër, diskuto trajtimin në kontabilitet të kërkuar nga SNRF-të. Arsyeto përgjigjen dhe trego nëse ka hyrje korigjuese në ditar në librat e Santa Fe sh.a. (12 pikë)

[Total: 20 pikë]

4. (a) Një aranzhim i përbashkët është një aranzhim në të cilin dy apo më shumë palë kanë kontroll të përbashkët.

Kontrol i përbashkët. Pajtimi përmes kontratës për ndarjen e kontrollit të një aranzhimi, i cili ekziston vetëm kur vendimet lidhur me aktivitetet relevante kërkojnë pajtimin unanim të palëve që ndajnë kontrollin.

Ekzistojnë dy lloje të aranzhimit të përbashkët:

Operacion i përbashkët dhe Sipërmarrje e përbashkët

Operacion i përbashkët

Pajtimi përmes kontratës për ndarjen e kontrollit të një aranzhimi, i cili ekziston vetëm kur vendimet lidhur me aktivitetet relevante kërkojnë pajtimin unanim të palëve që ndajnë kontrollin. Operacioni i përbashkët mund të jetë apo mos jetë entitet i ndarë ligjor. Secila palë do të regjistroj pjesën e tij të pasurive, detyrimeve, shpenzimeve dhe fitimeve të operacionit të përcaktuara nga substance e kontratës me të cilën është krijuar operacioni i përbashkët. Nuk ka nevojë për korigjime në konsolidim.

Sipërmarrje e përbashkët

Ky është një aranzhim nepërmjet të cilit palët kanë kontroll të përbashkët mbi pasuritë neto të sipërmarrjes (pra dallon nga pasuritë dhe detyrimet individuale). Do të jetë entitet ligjor i ndarë. Në këtë situatë, investimi kontabilizohet ose sipas koston, ose në pajtim me SNRF 9 në pasqyrat financiare individuale të secilit sipërmarrës. Në konsolidim, kontabiliteti i ekuitetit përdoret njëjtë sikur për ortakëtitë.

(b)

(i) Ky transaksion përfshin marrëveshjen ndërmjet Santa Fe sh.a dhe një partneri për të zhvilluar një projekt të vetëm. Nuk është krijuar entitet i ri, të dy palët me sa duket janë përgjegjëse për kostot e tyre, dhe janë pajtuar për ndarjen e të hyrave. Nuk ka kërkesa për marrëdhënie të vazhdueshme ndërmjet palëve.

Ky është qartë një operacion i përbashkët. Secila palë është përgjegjëse për pasuritë, detyrimet shpenzimet dhe fitimet e tyre, dhe do t'i kontabilizoj këto.

Santa Fe sh.a do të njoh €80 milion në të hyra pasi që anija do të përfundohet dhe kontrolli i është dorëzuar klientit.

Santa Fe sh.a do të njoh €62 milion në kosto të shitjes. Nuk do të njoh kostot apo të hyrat e atribuara tek prodhuesi i motorit.

Hyrjet:	€ milion	€ milion
D Paraja	80	
K Të hyrat (njohja e të hyrave dhe parasë së pranuar)		80
D Kosto e shitjeve	62	
K Paraja / të pagueshmet tregtare (njohja e kostove të shkaktura, të pagueshme ndoshta)		62

(ii) Ky transaksion duket së është një aranzhim ndërmjet dy palëve për të konstruktuar një pasuri të re dhe të menaxhohet bashkarisht.

Është formuar një entitet i ri, dhe secila palë ka kontribuar 50% të kapitalit të investuar. Duket se entiteti është nën kontroll të përbashkët, në të cilin asnjëra palë nuk ka kontroll të plotë në pasuritë apo detyrimet individuale të entitetit të ri. Andaj ky aranzhim është sipërmarrje e përbashkët.

Sipas SNRF 11, sipërmarrjet e përbashkëta kontabilizohen duke përdorur metosën e ekuitetit, njëjtë sikur ortakëritë. Entiteti i ri do të njihet në librat e Santa Fe në €130 milion (kosto e investimit). Vlera bartëse do të korihjohet me pjesën e fitimeve apo humbjeve të Santa Fe-së në sipërmarrjen e përbashkët. Në vitin actual, kjo do të jetë në shumë prej €2 milion (50% e €4 milion).

Hyrjet:	€ milion	€ milion
D Investimet në sipërmarrje të përbashkët	130	
K Paraja		130
(Njohja e investimit të berë në sipërmarrje të përbashkët)		
D Investimet në sipërmarrje të përbashkët	2	
K Fitimi ose humbja		2
(rnjohja e pjesës së fitimeve të fituara nga sipërmarrja e përbashkët gjatë vitit)		

(iii) Sipas SNRF 10, kontroll është aftësia për të drejtuar operacionet e një entiteti tjetër dhe përfitimi nga kjo.

Raleigh sh.a duket se është nën kontroll të Santa Fe.

Edhe pse ka 50% interes, me pak se sa automatikisht do të paraqiste kontrol, fakti që Santa Fe i merr të gjitha vendimet operationale dhe ka shumicen e bordit do të sugjeronte që kontrolli ekziston.

Raleigh sh.a duhet të konsolidohet me Santa Fe sh.a dhe 50% të njihet si IJK.

Hyrjet:	€ milion	€ milion
D Pasuritë	50	
K Detyrimet		45
K Interesat jo-kontrollues		2.5
K Rezervat e grupit		2.5
(njohja e neto pasurive të Raleigh sh.a me 1 gusht 2017 në llogaritë e grupit Santa Fe)		
D Rezervat e grupit / fitimi ose humbja	2.4	
D Interesat jo-kontrollues	2.4	
K Neto pasuritë		4.8
(njohja e humbjes për vitin e përfunduar me 31 korrik 2018 në llogaritë e grupit të Santa Fe)		

Problemi 5. SNK 16 – Prona, Fabrika & Paisjet tregon trajtimin në kontabilitet për shumicën e pasurive jo-qarkulluese. Kërkon që një ngarkesë vjetore të bëhet në pasyrën e të ardhurave për të reflektuar shumën e përfitimeve ekonomike të shoqëruara me pasurinë e konsumuar gjatë periudhës. SNK 16 gjithashtu lejon që pasuritë jo-qarkulluese të vlerësohen sipas vlerës së drejtë, nëse entiteti raportues zgjedh modelin e vlerës së drejtë. Gjithashtu në mënyrë specifike kërkon që rivlerësimet, sado të rregullta nuk e eliminojnë nevojën për një ngarkesë të zhvlerësimit.

Kërkohet:

- (a) Trego se si SNK 16 *Prona, Fabrika dhe Paisjet* i kërkon një entitet të llogarisë ngarkimin e zhvlerësimit në pronën, fabrikën dhe pasisjet e saj. (5 pikë)
- (b) Shpjego, duke iu referuar kërkesave të SNK 16 *Prona, Fabrika dhe Paisjet* se pse nuk është në rregull të lejohet rivlerësimi në baza të rregullta për të zëvendësuar ngarkesën e zhvlerësimit. (5 pikë)

(c) Lincoln sh.a, një operator i hoteleve, bleu një hotel si pasuri me 1 prill 2017 me një kosto prej €50 milion.

Kjo kosto është alokuar si në vijim:

	€ milion	Jeta e Përdorimit Ekonomik
Toka	12	Pakufishme
Ndërtesa	25	50 vite
Mobile dhe paisje	10	10 vite
Stoqe të shitjes me pakicë	3	Deri në shitje
Total	50	

Viti i përfunduar me 31 mars 2018:

Një renovim i pronës së hotelit të Lincoln sh.a është bërë me 1 prill 2017 me një kosto prej €10 milion. €3 milion prej kësaj kosto është alokuar te ndërtesa dhe €7 milion ishin mobilje dhe paisje shtesë. Një zhvlerësim i plotë vjetor është ngarkuar për vitin e përfunduar me 31 mars 2018. Stoqet janë shitur për €5 milion gjatë atij viti.

Viti i përfunduar me 31 mars 2019:

Prona e hotelit është rivlerësuar me 1 prill 2018 në €74 milion. Rivlerësimi është kryer nga një profesionist i cili ka siguruar detajet e mëposhtme:

	€ milion	Jeta e Përdorimit Ekonomik
Toka	18	Pakufishme
Ndërtesa	40	50 vite
Mobile dhe paisje	16	8 vite
Total	74	

Lincoln sh.a adopton një model të rivlerësimit të SNK 16 kurdo që i lejohet ta bëjë këtë. Nuk ka vlera të mbetura me përjashtim të tokës.

Kërkohet:

Tregoni hyrjet në ditar të nevojshme për të regjistruar transaksionin dhe ngjarjet mësipër në pasqyrat financiare të Lincoln sh.a për vitet e përfunduara me 31 mars 2018 dhe 2019. Çdo hyrje që afekton pasqyrën e performancës duhet të identifikohet qartë si “fitim ose humbje” apo “të ardhura tjera gjithëpërfshirëse”.

(10 pikë)

[Total: 20 pikë]

5.

(a) Një ngarkesë (debi) duhet të bëhet ndaj fitimit operativ ekuivalent me koston apo shumën e rivlerësuar të përfitimeve ekonomike të pasurive të prekshme fikse të konsumuara gjatë periudhës. Kjo bashkërendohet me një kredi në llogarinë e zhvlerësimit të akumuluar për atë lloj të pasurisë. Emërtimi më specifik brenda fitimit operativ duhet të përcaktohet në bazë të gjykimit.

Te kjo shumë arrihet duke alokuar shumën e zhvlerësimit të një pasurie në mënyrë sistematike përgjatë jetës ekonomike të përdorimit. Nuk përshkruhet asnjë metodë në veçanti, por metoda e zgjedhur duhet të reflektoj menyrën se si përfitimet e ardhshme nga pasuria pritët të konsumohen nga entiteti.

Shuma e zhvlerësueshme = koston (apo vlerësimin nëse rivlerësohet) minus vlerën e mbetur.

Vlera e mbetur e një pasurie është shuma e vlerësuar që një entitet do ta mirrte aktualisht nga shitja e pasurisë, pas zbritjes së koston së shitjes, nëse pasuria përdoret ende dhe në kushte me të cilat pritët të jetë në fund të jetës së përdorimit.

Të gjitha pasuritë fikse (jo-qarkulluese) përveç tokës e cila ka jetë të pakufishme të përdorimit, pronave investuese (që mbulohet nga SNK 40) dhe pasurivë të klasifikuara si të mbajtura për shitje (mbuluar nga SNRF 5) duhet të zhvlerësohen.

Nuk është e pranueshme të mos zhvlerësohet pasuria nëse shuma është jo-materiale. Megjithatë nëse ky është rasti një rishikim vjetor i dëmtimit duhet të kryhet për të siguruar se vlera bartëse e pasurisë nuk e tejkalon vlerën e saj të rikuperueshme.

Ngjajshëm, një rishikim vjetor për dëmtim duhet të kryhet nëse jeta ekonomike e përdorimit është më e gjatë se 50 vite.

Nëse metoda e zhvlerësimit, jeta ekonomike e përdorimit ose vlera e mbetur ndryshohet, ky nuk është ndryshim në politikë të kontabilitetit.

Është ndryshim në vlerësimet kontabël. Andaj nuk ka nevojë për korigjim të viteve të mëhershme. Vlerësimet e reja thjesht aplikohen në vlerën bartëse në datën e ndryshimit dhe më pas.

SNK 16 kërkon ndarjen e pasurive në komponentë të cilët kanë jetë të ndryshme ekonomike të përdorimit, nëse komponentët kanë vlerë të madhe krahasuar më koston totale të pasurive.

(b) Rivlerësimet janë konceptualisht të ndryshme nga ngarkesa e zhvlerësimit. Siç u përmend më lartë, zhvlerësimi është ngarkesë periodike në pasqyrën e të ardhurave i shumës së pasurisë të konsumuar gjatë periudhës.

Një rivlerësim është rimatje e vlerës së tregut të pjesës së mbetur të pasurisë.

Rivlerësimet trajtohen ndryshe nga kostot operative, andaj nuk është e qasje e drejtë që të përzihen.

Ilustrim për qëllim të të mësuarit:

Shuma e një pasurie të konsumuar nuk afektohet nga ndonjë ndryshim në vlerën e tij të tregut. Për të ilustruar këtë, imagjino një pasuri siç është një gropë e madhe e zhavorrit, që përmban një

shumë të caktuar të zhavorrit, p.sh 10 milion tonelata. Nëse zhavorri ka vlerë prej €10 për tonelatë në datën e blerjes, pasuria ka vlerë fillestare prej €100 milion.

Lë të themi që në vitin e parë 1, 1.5 milion tonelata të zhavorrit janë ekstraktuar, duke na mbetur 8.5 milion tonelata. Pasi që 15% e zhavorrit është harxhuar duket e arsyeshme të ngarkojmë 15% të kostos së pasurisë në pasqyrën e të ardhurave si zhvlerësim, ose or €15 milion.

Vlera bartëse tani është €85 milion.

Nëse, në fund të vitit 1, çmimi i zhavorrit është rritur në €15 për tonelatë, vlera e gropës së zhavorrit tani është €127.5 milion.

Nëse nuk do të ngarkonim zhvlerësimin, rezultatet operative do të ishin të shtrembëruara.

Ne e kontabilizojnë rritjen e vlerës së tregut duke e njohur një fitim nga rivlerësimi. Kjo llogaritet si diferenca ndërmjet vlerës së re dhe vlerës bartëse ($127.5 - 85 = 42.5m$). Kjo është në fakt rritja në vlerën e tregut të pjesës së mbetur të zhavorrit. Nuk është e përshtatshme që kjo të ketë ndonjë ndikim në rezultatin operativ andaj kreditohet tek TTGJ.

(c)

<u>Viti i përfunduar me 31 mars 2018:</u>	€ milion	€ milion
1 prill 2017 – blerja dhe njohja fillestare:		
D Prona, fabrika dhe paisjet	47	
D Stoqet	3	
K Paraja		50
(blerja e hotelit dhe klasifikimi si pasuri jo-qarkulluese dhe stoqe)		
1 prill 2017 – renovimi:		
D Prona, fabrika dhe paisjet	10	
K Paraja		10
(Kostot e renovimi, të gjitha të kapitalizuara si pasuri jo-qarkulluese)		
Gjatë vitit – shitja e stoqeve:		
D Paraja / të arketueshmet	5	
K Të hyrat		5
31 mars 2018 – zhvlerësimi për vitin:		
D Fitim ose humbje	2.26	
K Zhvlerësimi i akumuluar		
(ngarkesa e zhvlerësimit për vitin – shih llogaritjet më poshtë)		2.26

Llogaritjet: Zhvlerësimi është llogaritur sipas komponentës si në vijim:

Komponenta	Kosto	Jeta e Përdorimit Ekonomik	Zhvlerësimi për vitin
Ndërtesa	$25 + 3 = 28m$	50 vite	€0.56 m
Mobile dhe paisje	$10 + 7 = 17m$	10 vite	<u>€1.70 m</u>
Total			€2.26 m

Viti i përfunduar me 31 mars 2019:

1 prill 2018 – Rivlerësimi

Shuma e rivlerësuar	74
Vlera bartëse (47 + 10 – 2.26)	<u>(54.74)</u>
Fitimi nga rivlerësimi	19.26

	€ milion	€ milion
D Prona, fabrika dhe paisjet (74 – 57)	17	
D Zhvlerësimi i akumuluar	2.26	
K Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse (TTGJ)		19.26
(fitimet nga rivlerësimi të kredituara tek TTGJ)		

31 mars 2019 – Zhvlerësimi i vitit:

D Fitimi ose humbja	2.8	
K Zhvlerësimi i akumuluar		2.8
(ngarkimi i zhvlerësimit për vitin – shih llogaritjet më poshtë)		

Llogaritjet: Zhvlerësimi llogaritet si një në bazë të komponentës si në vijim:

Komponenta	Kosto / vlerësimi	Jeta e Përdorimit Ekonomik	Zhvlerësimi për vitin
Ndërtesa	40m	50 vite	€0.8 m
Mobile dhe paisje	16m	8 vite	<u>€2.0 m</u>
Total			€2.8 m

Shënime për mësim:

- Zhvlerësimi i akumuluar behet zero sa here që të kemi rivlerësim.
- Fitimet nga rivlerësimi kreditohen tek TTGJ, dhe teprica e rivlerësimit, përveç nëse anulon fitimet e mëhershme të ngarkuara tek fitimi ose humbja.
- Hoteli është një pasuri e vetme, andaj fitimi nga rivlerësimi llogaritet si një shifër e vetme, edhe pse në faza nëpër komponentë të ndryshëm
- Llogaritjet e përgjithshme në vijim mund të jenë të dobishme për të gjurmuar të gjitha korigjimet. Ngjarjet duhet të regjistrohen në rënditje kronologjike, siç ndodhin.

Llogaritjet shitesë:

	Toka €m	Ndërtesa €m	Mobile dhe paisje €m	Total €m
Blerja 1 prill 2017	12	25	10	47
Renovimi 1 prill 17	0	3	7	10
Zhvlerësimi deri me 31 mars 18	<u>0</u>	<u>(0.56)</u>	<u>(1.7)</u>	<u>(2.26)</u>
Vlera bartëse 1 prill 18	12	27.44	15.3	54.74
Rivlerësimi 1 prill 18	<u>6</u>	<u>12.56</u>	<u>0.7</u>	<u>19.26</u>
Vlera bartëse e korigjuar	18	40	16	74
Zhvlerësimi deri me 31 mars 19	<u>0</u>	<u>(0.8)</u>	<u>(2)</u>	<u>(2.8)</u>
Vlera bartëse 31 mars 19	18	39.2	14	71.2